

LIGJ
Nr. 145/2015

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 383, DATË 24.2.2011, "PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSORNË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 5, pika 1, bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën "b", pas fjalëve "personat e vetëpunësuar" shtohen fjalët "me përjashtim të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 7, të këtij ligji, të cilët nuk kanë detyrimin për të paguar kontribute të sigurimeve të kujdesit shëndetësor".

2. Në shkronjën "c", pas fjalëve "punonjësit e papaguar të familjes" shtohen fjalët "për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave".

Neni 2

Në nenin 6, pika 1, pas fjalëve "dhe punonjësit e papaguar të familjes" shtohen fjalët "për tatimpaguesit e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave".

Neni 3

Në nenin 7, "Baza për llogaritjen e kontributeve", pas pikës 3 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Për kategori të veçanta personash, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale, përfshirë edhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë e bashkëtojnë me të vetëpunësuarin, profesionet, paga për efekt të llogaritjes së kontributeve, nga paga minimale deri në pagën maksimale, si dhe kriteret e përcaktimit të saj caktohen nga Këshilli i Ministrave."

Neni 4

Në nenin 12, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj personave të pasiguruar, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- a) shërbimi i urgjencës mjekësore;
- b) shërbimi/përfitimi i paketës së kontrolleve periodike parandaluese në popullatë, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) vizita te mjeku i familjes."

Neni 5

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më datën 1 janar 2016.

Miraturar në datën 17.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9397, datë 7.1.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

